



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 2635/1 prot.

Elbasan, me 06.11.2023

**VENDIM**

Nr 35 datë 06.11.2023

**"Për**

**ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024, të studentëve të Ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit e miratimit të rasteve për studentët e shkëlqyer, studentët me rezultate dhe studentët që plotësojnë kriteret e tjera për: përfitim burse, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

- A. Ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate ( me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kriteret e tjera, për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024, të studentëve të Ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi me përbërje si më poshtë:
1. Filip Qosja – kryetar (menaxhimin e komisionit për realizimin e procedurave, përgatitjen e materialeve për Administratorin dhe relatimin e këtij materiali në Bordin e Administrimit)
  2. Eglantina Zaçe – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
  3. Romina Pitja – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
  4. Enea Qevani – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
  5. Laureta Bajrami – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
  6. Daniela Gërdani – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)

7. Fejzie Musta – anëtare (Procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
  8. Arta Skënderi – anëtare (përgatitjen e listave për verifikim në institucione, procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
  9. Rovena Zane – anëtare (përgatitjen e listave për verifikim në institucione, procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
  10. Armida Gjata – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
  11. Marsela Balla – anëtare (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe porokollimi i tyre)
  12. Etleva Sejдини – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
  13. Blerina Hyra – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
- B. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
- C. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së dhe të bëhet përpunimi i tyre.
- D. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për shqyrtim e miratim rast pas rasti në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
- E. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**

**ARDIAN DURMISHI**

